



Në bazë të Udhëzimit Administrativ (QRK) nr.03/2018 për gjuhët e huaja në programin e studimit të ciklit të dytë apo të tretë, Senati i Kolegjit AAB në mbledhjen e mbajtur me datën 17.05.2019 mori këtë:

V E N D I M

1. Kriter minimal për pranim në programin e studimit: Gjuhë Angleze (MA) caktohet niveli B1.
 - a. Në rast të mos plotësimit të numrit të lejuar për regjistrim në programin e studimit Gjuhë Angleze (MA), atëherë mund të pranohen edhe me nivelin A2.
2. Kriter minimal për pranim në programet tjera të studimit të ciklit të dytë (master) caktohet niveli A2.
 - a. Në rast të mos plotësimit të numrit të lejuar për regjistrim në këto programe të studimit, atëherë mund të pranohen edhe me nivel më të ulët.
3. Obligohen të gjitha dekanatet e fakulteteve, shërbimi i administratës, zyra për regjistrim që të bëjnë njoftimin e studentëve, përgatitjen, zhvillimin e kurseve përgatitore etj.
4. Obligohet shërbimi teknik që të bëjë të gjitha përgatitjet për implementimin e provimeve që do të mbahen në Kolegjin AAB pasi që AAB është caktuar si qendër testuese për rajonin e Prishtinës.
5. Vendimi hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.




Prof. Ass. Dr. Lulzim Tafa, Rektor